

VENDIM
Nr. 445, datë 19.6.2026

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE NR. 1 TË MARRËVESHJES
SË GRANTIT, PËR PROGRAMIN KOMBËTAR TË MODERNIZIMIT TË SEKTORIT
TË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE NË SHQIPËRI, NGA FONDI I MIRËBESIMIT
ME NJË DONATOR, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS
NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM, QË VEPRON SI
ADMINISTRATORE E PROGRAMIT KOMBËTAR TË MODERNIZIMIT TË
SEKTORIT TË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE NË SHQIPËRI, NGA FONDI I
MIRËBESIMIT ME NJË DONATOR, MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 170, DATË
24.3.2023, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese nr. 1 të marrëveshjes së grantit, për Programin Kombëtar të Modernizimit të Sektorit të Ujësjiellës-Kanalizimeve në Shqipëri, nga Fondi i Mirëbesimit me një Donator, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim, që vepron si administratore e Programit Kombëtar të Modernizimit të Sektorit të Ujësjiellës-Kanalizimeve në Shqipëri, nga Fondi i Mirëbesimit me një Donator, miratuar me vendimin nr. 170, datë 24.3.2023, të Këshillit të Ministrave, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Ndryshim i Marrëveshjes së Grantit për Programin e Modernizimit të Sektorit të Ujësjellës-Kanalizimeve në Shqipëri – Fond Mirëbesimi me Donator të Vetëm

NDRYSHIMI NR. 1 I MARRËVESHJES SË GRANTIT

NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

DHE

BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

(duke vepruar si Administratore e Fondit të Mirëbesimit me Donator të Vetëm për Programin e Modernizimit të Sektorit të Ujësjellës-Kanalizimeve në Shqipëri)

1. Informacion paraprak

1.1 Përfituesi dhe Banka kanë lidhur një **Marrëveshje Granti** (Granti nr. TF0B8448-AL) në datën 24.3.2023 (Marrëveshja e Grantit) që vë në dispozicion 6.3 milionë euro në mbështetje të Programit.

1.2 Grafiku 2, seksioni III, klauzola 2 e Marrëveshjes së Grantit përcakton **datën e mbylljes** si 31 dhjetor 2025.

1.3 Përfituesi ka kërkuar një zgjatje të datës së mbylljes për ta përafuar më mirë me datën e mbylljes së hua-programit për rezultate (PforR), 31 dhjetor 2027, dhe Banka ka rënë dakord me këtë zgjatje afati, pa ndryshuar objektivat apo shumat e grantit.

2. Ndryshimet e Marrëveshjes

2.1 Ndryshimi në grafikun 2 “Zbatimi i projektit”, seksioni III “Tërheqja e Fondeve të Grantit”, pika B “Kushtet e tërheqjes; periudha e tërheqjes”, klauzola 2.

Në vend të:

“2. Data e mbylljes është 31 dhjetor 2025.”

Do të lexohet:

“2. Data e mbylljes është 30 nëntor 2027.”.

2.2 Hyrja në fuqi

Me hyrjen në fuqi të kësaj letre, çdo kërkesë disbursimi e paraqitur në kuadër të Grantit përpara datës fillestare të mbylljes, mund të mbetet e vlefshme dhe të përpunohet, me kërkesë të përfituesit, në përputhje me kushtet e grantit.

Në rast se kjo marrëveshje nënshkruhet pas datës 31 dhjetor 2025, do të ketë efekt prapaveprues, duke garantuar vijueshmërinë e zbatimit të projektit.

Përveç ndryshimeve të shprehura këtu, të gjitha termat dhe kushtet e tjera të Marrëveshjes së Grantit dhe anekseve të saj mbeten në fuqi dhe efekt të plotë.

RANË DAKORD në datën e nënshkrimit:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nga:

Përfaqësuesi i Autorizuar

Emri: Petrit Malaj

Titulli: Ministër i Financave

Data: 9.4.2026

BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

(duke vepruar si Administratore e Fondit të Mirëbesimit me Donator të Vetëm për Programin e Modernizimit të Sektorit të Ujësjellës-Kanalizimeve në Shqipëri)

Nga:

Përfaqësuesi i Autorizuar

Emri: Massimiliano Paolucci

Titulli: Menaxher i Vendit

Data: 5.5.2026

